



THIRRJE PËR OFERTIM

CALL FOR OFFER

Titulli i projektit / Project Title:	KO-in-EU "Shaping Kosovo's EU Future: Establishing a Centre of Excellence on European Union's Integration, Values, Role and Impact"
Titulli i aktivitetit / Activity Title:	Blerje e paisjeve per qellim te implementimit te projektit
Numri i referencës së projektit / Project Reference Number	101239564
Agjencia donatore / Sponsoring Agency:	Erasmus + CBHE
Periudha e implementimit të projektit/ Project Implementation Period:	36

1. Informata rreth Kolegjit AAB

Kolegji AAB është institucioni i parë jopublik i arsimit të lartë në Kosovë i cili është themeluar menjëherë pas luftës në Kosovë, pas krijimit të rrethanave të reja ekonomike-sociale e kulturore, kur u krijuan kushte dhe rrethana për jetë normale të qytetarëve të Kosovës. Në fillimet e tij institucioni ofroi programe studimore nga fusha e Artit dhe Komunikimit Masiv duke u zgjeruar vazhdimisht me programe studimore në fushat e tjera dhe duke u shndërruar kështu në institucion model të arsimit të lartë, jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon. Sot, Kolegji AAB ofron programe studimi të nivelin baçelor dhe master në 14 fakultete të ndryshme. Njëkohësisht, Kolegji AAB është implementues i shumë projekteve ndërkombëtare që kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë.

2. Informata të përgjithshme rreth projektit

Kjo thirrje është e hapur në kuadër të projektit "Shaping Kosovo's EU Future: Establishing a Centre of Excellence on European Union's Integration, Values, Role and Impact" i cili ka për qëllim krijimin e një Qendre Ekselence që synon të avancojë njohuritë dhe kapacitetet e institucioneve dhe individëve në Kosovë mbi Bashkimin Evropian, me fokus në integrimin, vlerat, rolin dhe ndikimin e tij. Projekti synon të ofrojë një platformë të strukturuar për hulumtim, edukim dhe trajnime profesionale, duke zhvilluar ekspertizë të specializuar tek studentë, akademikë dhe profesionistë. Përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe aktiviteteve akademike të bazuara në evidencë, qendra do të kontribuojë në forcimin e vendimmarrjes së informuar, promovimin e ekselencës në kërkim dhe edukim, dhe mbështetjen e integritimit evropian të Kosovës në mënyrë të qëndrueshme. Projekti parasheh aktivitete të strukturuar për të fuqizuar ekspertizën mbi integrimin evropian dhe ndikimin e Bashkimit Evropian në Kosovë. Ai përfshin



projekte bashkëpunuese hulumtuese ndërdisiplinore mbi demokratizimin, zhvillimin ekonomik dhe sundimin e ligjit, si dhe krijimin e **Observatorit të Ndikimit të BE-së** për monitorimin dhe vlerësimin e iniciativave të financuara nga BE-ja, me publikimin e gjetjeve në formate të aksesueshme. Projektit i shtohen dy **Shkolla Verore** mbi integrimin evropian, një **Hackathon** për zgjidhje inovative dhe një **Konferencë Vjetore mbi Marrëdhëniet Kosovë-BE**, si dhe **forume shkëmbimi njohurish** për akademikë, politikëbërës dhe praktikues. Këto aktivitete synojnë të promovojnë bashkëpunimin ndërdisiplinor, zhvillimin e ekspertizës dhe hartimin e politikave të informuara, duke mbështetur integrimin e qëndrueshëm evropian të Kosovës. Projekti financohet nga programi Erasmus+ CBHE i Bashkimit Evropian.

3. Objekti i ofertës

Të gjitha bizneset e regjistruara në Kosovë që të dorëzojnë ofertat e tyre për blerjen e pajisjeve të listuara në vijim:

Nr.	Emërtimi i pajisjeve/	Specifikat teknike të pajisjeve	Sasia
1	Smart Board	Tabele Interaktive LT75, 75" Riotouch IR android 13.0, CPU: Octa core, RAM: 8GB, ROM: 128GB, Infrared Touch, HDMI, Type-C, DP, VGA, Speakers: 15W*2	2
2	Laptops	LENOVO THINKPAD L13 YOGA i5 1335U 256GB 16GB DDR5 13.3" WUXGA	3
3	PC	i5 , 16GB, 240GB, - Monitor 24"	2
4	Printer	Printer Pantum P2500W	1

4. Kushtet dhe kriteret për aplikim

Të gjitha bizneset e interesuara duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Ofertën financiare (bazuar në specifikat, çmimin e ofruar për njësi dhe kohën e liverimit).
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit
- Certifikatën e TVSH-së



Kolegji AAB

Rr. "Elez Berisha", nr. 56, Zona Industriale Prishtinë-
Fushë Kosovë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës,
Tel: +383 38 600 005; +383 45 284 797
Mail: info@aab-edu.net;
www.aab-edu.net

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në formë elektronike në email-in dardan.krekaj@universitetiaab.com dhe projects@universitetiaab.com me subject "Ofertë për "KO-in-EU". Çdo formë tjetër e dorëzimit të ofertave do të konsiderohet e papranueshme.

Afati për dorëzimin e ofertave është më 09.01.2026, në ora 16:00.

Përzgjedhja e fituesit do të bëhet në bazë të kritereve si në vazhdim: çmimit ekonomikisht më të favorshëm (40 pikë), përmbushjes së specifikave teknike (40 pikë), dhe kohës së liferimit (20 pikë).



Co-funded by
the European Union